

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

19 janar 2010
Prishtinë
Ap.-Kz. Nr. 413/2009

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Emilio Gatti si Kryetar i kolegjit, Gjyqtarës së EULEX-it Maria Giuliana Civinini dhe Gjyqtarit Kosovar Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit,

në procedurën penale kundër:

G.H., mashkull, Shqiptar i Kosovës, emri i të atit H., mbiemri i vajzërisë i së ëmës S.O., i lindur më xxxxxx në Fshatin xxxx, Komuna e Prizrenit, adresa e tanishme rruga 'xxxxxxxxxxxxx në Prizren, numri i letërnjoftimit xxxxxx, i martuar, baba i 3 fëmijëve, me profesion kamerier, shkollën fillore të kryer, me gjendje shumë të varfër financiare, në paraburgim prej datës 7 maj 2008 deri më 2 qershor 2008 dhe në arrest shtëpiak prej datës 2 qershor 2008 deri më 6 gusht 2008; i akuzuar me aktakuzë HP. Nr. 339/06 të datës 14 korrik 2008 për kryerje të veprës penale të pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale (si udhëheqës) sipas nenit 200 (2) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK).

Duke vendosur sipas ankesës në Gjykatën e Qarkut në Prizren ndaj Aktgjykimit P. nr. 339/06, të datës 28 shtator 2009, që dënon G.H.n për kryerjen e veprës penale të pjesëmarrjes në grumbullim që kryen dhunë nën nenin 200 (1) LPK dhe që i shqipton dënimin me kusht prej 6 (gjashtë) muajve burgim, ankesa e cila ishte paraqitur nga ana e avokatit mbrojtës më 2 nëntor 2009.

Pas dëgjimit të parashtrësave të avokatit mbrojtës Z. A.M.dhe mendimin dhe propozimin e Prokurorit të EULEX-it Z. Johannes Pieter Van Vreeswijk në seancën e mbajtur më 19 janar 2010 dhe pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 19 janar 2010.

Duke vepruar sipas nenit 420 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK) lëshon këtë

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur në interes të G.H. më 2 nëntor 2009 me këtë REFUZOHET si e pabazuar.

Sipas nenit 391 (5) të KPPPK-ë, koha që i pandehuri ka kaluar në paraburgim prej datës 7 maj 2008 deri më 2 qershor 2008 dhe në arrest shtëpiak prej datës 2 qershor 2008 deri më 6 gusht 2008 është përfshirë në kohëzgjatjen e dënimit.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren P. nr. 339/06, i datës 28 shtator 2009 vërtetohet në tërësi.

Shpenzimet e procedurës së shkallës së dytë do ti mbulojë ankuesi.

ARSYETIMI

Historia e procedurës

1. Më 17 dhe 18 mars 2004 një numër i madh i shqiptarëve të Kosovës kanë marrë pjesë në demonstrata dhe trazira të dhunshme në qytetin e Prizrenit duke shkaktuar dëme në pronat dhe vendbanimet private të qytetarëve dhe në ndërtesat dhe veturat pronë e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), gjatë atyre demonstratave personat përfshirë edhe policët kanë pësuar lëndime.

Sa i përket 17 marsit 2004, kjo procedurë në veçanti ka të bëjë me faktet që kanë ndodhur në një pjesë të Prizrenit nga rruga “Zahir Pajaziti” që shtrihet afër ndërtesës së Ben Af-it deri te Shadërvani dhe hotel “Theranda”, sa i përket 18 marsit 2004 kjo ka të bëjë me faktet që kanë ndodhur në mes të Shadërvanit dhe Shtëpisë së Armatës.

2. Kundër G.H., Prokurori publik ndërkombëtar ka paraqitur aktakuzë më 8 gusht 2008 për tri vepra sipas neneve 200 (2), 200 (1) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK-së) dhe sipas nenit 23 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së). Aktakuza është vërtetuar vetëm në Pikën 1, pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale (si udhëheqës) sipas nenit 200 (2) të Ligjit Penal të Kosovës me aktvendimin e datës 20 tetor 2008, pikat e mbetura janë hedhur poshtë.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 18 qershor 2009, është mbajtur në prani të Prokurorit publik, të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës, dhe përfshinë 6 shqyrtime deri më 28 shtator 2009.

Në shqyrtimin e 28 shtatorit 2009 aktgjykimi është shpallur.

G.H. është shpallur fajtor për pjesëmarrje në grumbull që kryen dhunë sipas nenit 200 (1) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK-së) dhe i është shqiptuar dënim me kusht prej 6 (gjashtë) muaj burgim.

3. G.H. është arrestuar dhe është mbajtur në paraburgim nga 7 maji 2008 deri më 2 qershor 2008 dhe nga 2 qershori 2008 deri më 6 gusht 2008 në arrest shtëpiak.

4. Aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar të pandehurit më 3 nëntor 2009 dhe avokatit të tij më 28 tetor 2009.

Avokati mbrojtës ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit më 2 nëntor 2009.

Përgjigja e Prokurorit publik të qarkut në Prizren është paraqitur më 11 nëntor 2009.

Mendimi i ZPShK-së është shprehur më 29 dhjetor 2009.

5. Gjykata Supreme e Kosovës ka caktuar seancën ankimore më 19 janar 2010, ku pas raportit të gjyqtarit raportues, i pandehuri ka ofruar sqarim lidhur me ankesën dhe Prokurori i EULEX-it i është përgjigjur siç është cekur në procesverbal.

6. Gjykata ka mbajtur këshillimin më 19 janar 2010.

Gjetjet e gjykatës

I

7. Sipas nenit 415 të KPPPK-së, gjykata e shkallës së dytë do të ekzaminoj ex officio disa shkelej të ligjit të procedurës dhe ligjit penal.

Duke u rezervuar për paragrafët në vijim ekzaminimi i pohimeve të ngritura nga ankesa, këtu mund të vërehet se:

- nuk gjendet asnjë shkelje sa i përket përbërjes së gjykatës së shkallës së parë dhe pjesëmarrjes së gjyqtarëve në shqyrtim gjyqësor dhe në marrjen e aktgjykimit (neni 403.1, pikat 1 dhe 2), sa i përket kompetencave të të njëjtës gjykatë (neni 403.1, pika 6) dhe sa i përket pikave 9, 10 dhe 11 të nenit 403.1 të KPPPK-së,
- shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në prani të të akuzuarit dhe avokatit të tij mbrojtës (neni 415, pikat 1 dhe 3).

II

8. Ankesa e Z. A.M.e paraqitur më 2 nëntor 2009, kundërshton aktgjykimin e shkallës së parë për shkak të:

- shkeljes themelore të procedurës penale (neni 403, paragrafi 1, pakat 8 dhe 12 të KPPPK-së),
- vërtetim i gabuar i gjendjes faktike (neni 405 i KPPPK-së) dhe
- shkeljes së ligjit penal (neni 404 i KPPPK-së).

Avokati mbrojtës propozon:

- të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë dhe të lirohet i pandehuri G.H. nga akuzat sipas nenit 390, paragrafit 1, pikës 3 të KPPPK-së.

9. Sa i përket shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale, ankesa pretendon si në vijim.

- Paqartësia e dispozitivit, kundërthënia në vetvete dhe në pjesën e arsyetimit dhe mungesa e arsyetimit sa i përket fakteve vendimtare.

Këto pretendime nuk janë të vërtetuara në ankesë.

Këtu mund të vërehet se dispozitivi merr në mënyrë shumë të qartë dënimin e G.H. për veprat penale të parapara me nenin 200 (1) të LPK-së, e që është pjesëmarrja në grup që kryen dhunë të madhe, zjarrvënie, dëme të konsiderueshme dhe lëndime të rënda trupore kurse pjesa e arsyetimit sqaron sjelljen e të pandehurit për të dy ditët e demonstratave dhe rezultatin e sjelljes së grupit në të cilin ka marrë pjesë vetë H.

Në vetvete dhe nën këtë pikëpamje procedurale të dy pjesët e aktgjykimit të kundërshtuar, dispozitivi dhe arsjetimi nuk duken të jenë kundërthënëse me njëra tjetrën. Vetë dispozitivi nuk përmban paqartësi.

Sa i përket mjaftueshmërisë së arsjetimit mund të vërehet se gjykata e shkallës së parë së pari shqyrton të gjitha dëshmitë e propozuara nga palët (faqet 4 - 25), pastaj ekzaminon në mënyrë kritike duke arritur në përfundimin e saj në pjesën e fundit të aktgjykimit (faqet 25 - 33).

Në arsjetimin e saj gjykata e shkallës së parë merr parasysh në mënyrë të duhur të gjitha faktet vendimtare të sjella për ekzaminim dhe që kanë të bëjnë 1) me praninë e të pandehurit në grupin që demonstronte gjatë ditëve kritike, 2) me kontributin e tij material në aktet e dhunshme për të cilat është akuzuar dhe 3) mbrojtjen e tij.

Prandaj këto pretendime të ankesës janë të pabazuara.

- Arsyet e dhëna janë në kundërthënie me përmbajtjen e dëshmive të administruara, posaçërisht me dëshmitë e dëshmitarëve F.V., S.B.dhe A.B.lidhur me momentin kur i pandehuri është larguar nga Tregu Qylhani në Prizren në pasditen e 17 marsit 2004.

Pretendimi është i pabazuar.

Pjesa e arsjetimit të aktgjykimit të kundërshtuar nuk i paraqet dëshmitë e këtyre dëshmitarëve në mënyrë kundërthënëse me përmbajtjen e dëshmive të administruara.

Çfarë deklaruan ata është përshkruar saktësisht (në faqet 18 - 21) dhe formon objekt të shqyrtimit kritik (faqet 30 dhe 31).

Korrektësia e vlerësimit të bërë nga gjykata e shkallës së parë sa i përket këtyre dëshmive është pjesë e vërtetimit të gjendjes faktike (shih më tutje paragrafin **II.10**) dhe nuk ka të bëjë me gabimet mundshme procedurale.

- Papranueshmëria e deklaratave të dhëna nga H.M.dhe P.B.në Polici.

Ankesa pretendon se kur H.M.dhe P.B.i kanë dhënë deklaratat e tyre në Polici ata ishin të “dyshuar” për kryerjen e krimit njëjtë sikur i pandehuri dhe janë marrë në pyetje në cilësinë e të “dyshuarve”.

Më vonë gjykata e shkallës së parë ka dëgjuar këta dy persona si “dëshmitarë” dhe jo si “të dyshuar”. Prandaj gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur ti shfrytëzoj deklaratat e tyre në Polici, të cilat është dashur të konsiderohen si dëshmi të papranueshme (shkelje e nenit 403, paragrafi 1, pika 8 e KPPPK-së).

Ky pretendim është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se H.M.është intervistuar nga Policia më 7 prill 2004 dhe më 8 dhjetor 2006, në të dy rastet si i dyshuar.

Në të dy rastet ai është njoftuar me kohë për të drejtat e tij si i dyshuar dhe ai ka konfirmuar me shkrim se i ka kuptuar ato, për të heqjen dorë nga e drejta për heshtje dhe nuk ka kërkuar avokat (shih aktgjykimin e kundërshtuar në faqen 10, procesverbali i deklaratës në Polici të datës 8 dhjetor 2006, procesverbali i deklaratës në Polici të datës 7 prill 2004 dhe dokumentin e bashkangjitur)

Si i dyshuar M. ka folur sjelljen e të dyshuarit tjetër H..

M më vonë është paraqitur në shqyrtimin gjyqësor si dëshmitar është ekzaminuar nga palët lidhur me sjelljen e të pandehurit H..

Gjatë ekzaminimit të tij gjyqësor M. i janë përkujtuar deklaratat e tij të mëparshme sipas nenit 364 të KPPPK-së (shqyrtimi i 18 qershorit 2009, faqet 21 dhe ff).

Prandaj deklaratat e dhëna nga H.M.gjatë fazës hetimore janë konsideruar në mënyrë të duhur si dëshmi të pranueshme.

Në të vërtetë asnjë dispozitë ligjore nuk e ndalon shfrytëzimin e deklaratave të dhëna nga i dyshuari gjatë fazës hetimore, edhe pse më voni ai bëhet dëshmitarë.

Është e rëndësishme se në njërin anë kur i dyshuari është ekzaminuar atij i janë dhënë garancitë e parapara me nenet 229 deri në 236 të KPPPK-së (neni 156, paragrafi 1) dhe që gjatë një faze të procedurës palëve ju është dhënë mundësia që ta kundërshtojnë dëshminë e tij (neni 157, paragrafi 1).

Në këtë rast të dy kushtet e lartpërmendura janë përmbushur.

Sa i përket dëshmisë së P.B.duhet vërejtur se gjykata e shkallës së parë (faqet 29 dhe 30) nuk kanë përdorur deklaratat e tij në dëm të të akuzuarit sepse në Polici dhe gjatë hetimeve dhe gjatës gjykatës së parë ky dëshmitar nuk e ka njohur askënd në fotografitë që i janë treguar atij dhe nuk ka mundur ta akuzojë të pandehurin.

Prandaj dëshmia e këtij dëshmitari duket të jetë e parëndësishme.

10. Në pikën lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ankesa pretendon si në vijim.

- Ekzistimi i dëshmime kundërthënëse sa i përket sjelljet e të pandehurit më 17 mars 2004.

Pretendimi i referohet përmbajtjes së dëshmime të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor nga dëshmitarët F.V., S.B.dhe A.B.lidhur me momentin kur i pandehuri është larguar nga

Tregu Qylhani në Prizren në pasditen e 17 marsit 2004, koha është treguar për afërsisht 17:00 (shih më tutje).

I pandehuri ka dhënë dy versione të ndryshme: së pari i ka thënë se është larguar nga tregu në mes të orës 3 dhe 4 pasdite (Prokurorit ndërkombëtar më 19 mars 2004), pastaj ka thënë se është larguar nga tregu në ora 17:00 (gjatë seancës për konfirmim dhe shqyrtimit gjyqësor).

Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar dëshmitë e tre dëshmitarëve sepse më shumë ka pasur të bëjë me rutinën e punës së përditshme se sa me përqendrimin preciz në faktet e 17 marsit 2004, dhe për shkak se ato dëshmi janë kundërshtuar me atë çfarë vetë i pandehuri ka deklaruar pranë Prokurorit publik ndërkombëtar më 19 mars 2008.

Për arsye të njëjta gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka refuzuar dëshminë e të pandehurit gjatë gjykimit.

Kjo gjykatë ndan mendimin e gjykatës së shkallës së parë. Nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor rezulton si më poshtë: F.V. (shqyrtimi i datës 24 qershor 2009) ka deklaruar se H. kishte punuar në treg, në tezgën e vet deri në orën pesë pasdite.

Ajo megjithatë e bëri të qartë se më shumë po fliste në bazë të rutinës së zakonshme sesa në bazë të kujtesës për atë ditë: ajo përsëriste se pronarët e tezgave ikin në atë orë “çdo ditë” dhe në vërejtjen e prokurorit “pra ky është supozim dhe jo nga kujtesa e saktë”, ajo u përgjigj “e saktë, unë gjithnjë ik në orën pesë” (faqe 6).

S.B.(shqyrtimi i datës 24 qershor 2009, faqe 10 deri në 12) ka deklaruar se H. ka punuar në tezgën e tij të tregut deri në orën 5 pasdite, duke pranuar se kishte mundur të ikte 15 – 30 minuta më herët dhe se nuk ishte i sigurt sa ishte ora saktësisht sepse nuk e kishte orën kur shkoi H..

Zakonisht, shtoi ai, pronarët e tezgave fillonin t’i paketonin dhe t’i largonin plaçkat e tyre afërsisht 30 minuta para mbylljes së portës së tregut në orën pesë pasdite.

A.B.(shqyrtimi i datës 24 qershor 2009, faqe 15), motra e të pandehurit, ka deklaruar se H. kishte punuar në treg deri në orën pesë, duke shtuar se ata zakonisht ikin nga tregu në ora 4:30 deri në pesë pasdite.

Siç është konstatuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, të gjitha këto dëshmi duken të jenë të bazuara më tepër në rutinë sesa në përkujtimin e saktë të asaj dite. Ata nuk theksojnë asnjë fakt specifik që do t’i vërtetonte deklaratat e tyre lidhur me orën kur i pandehuri doli nga tregu.

Për më tepër, këto dëshmi kundërshtohen nga deklaratat e të pandehurit më 19 maj 2008 para prokurorit publik ndërkombëtar, kur e kishte pranuar se tregu e kishte lëshuar në mes orës 3 dhe 4 pasdite.

I përballur me deklaratat e tij të mëhershme, deklaratat e të pandehurit duken të jenë të motivuara me mbrojtjen e vet dhe për këtë nuk duken të jenë të besueshme. Për këtë arsye, ky pretendim i ankesës nuk është i bazuar.

Së dyti, ankesa thekson mungesën e dëshmimeve përkitazi me pjesëmarrjen e të pandehurit (si udhëheqës) i grupit që kryen veprën penale, duke shtuar se ai në të vërtetë i kishte ndihmuar njerëzit në nevojë gjatë demonstratave të 17 marsit dhe ua kishte tërhequr vërejtjen pronarëve të dyqaneve që t'i mbyllin të njëjtat më 18 mars. Kjo pikë është e pabazë.

Së pari, duhet të vërehet se aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban dënimin e të pandehurit si “udhëheqës” (neni 200, par. 2 i LPK-së), por vetëm si “pjesëmarrës” (neni 200, par. 1 i LPK-së) i grupit që kryen veprën penale.

Së dyti, mund të vërehet se gjetjet e gjykatës së shkallës së parë në këtë drejtim duken të jenë të sakta lidhur me dëshmitë e mbledhura. Në shkresat e lëndës janë fotografitë që tregojnë të pandehurin G.H. së bashku me persona të tjerë në mesin e të cilëve dhe H.Sh., si pjesëmarrës në këto manifestime (provat materiale P3, P4a, P9, P12 dhe C5).

Këto foto janë identifikuar nga dëshmitari H.Sh.dhe H.M.si momente që paraqesin këto manifestime. Këta dy dëshmitarë kanë konfirmuar pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të të pandehurit në manifestimet e dhunshme të atyre dy ditëve.

I pandehuri ka pranuar se ka qenë i pranishëm (“i rrethuar nga turma”) në turmën e datës 17 mars dhe ka ecur me demonstruesit për një orë një distancë rreth 1.5 deri në 2 kilometra dhe atë nga rruga Zahir Pajaziti deri tek objekti i Ben Afit, te Shatervani dhe hoteli Theranda.

Për më tepër, i pandehuri ka identifikuar veten në disa foto (prova C5) ku paraqiten pjesëmarrësit e manifestimeve të datës 18 mars 2004, në një rën prej të cilave ai po mbante flamurin. Atë ditë ai kishte qenë me protestuesit për dy orë.

Gjatë intervistës në polici, dëshmitari **B.B**ka konfirmuar se një foto ku paraqitet i pandehuri (prova P9), paraqiste burrin i cili më 18 mars i ishte kërcënuar që mos ta fotografonte gjatë manifestimit.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar besueshmërinë e kësaj deklaratë të parë të z. Kabashit dhe mosbesimin ndaj mohimit të kësaj që ai e kishte bërë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë (faqet 12, 13 dhe 29), të bazuara në ekzistencën e një shënimi të shkruar nga vetë K. ku ai konfirmonte kërcënimet që vinin nga H., duket të jetë korrekt dhe i lirë nga të gjitha metat procedurale.

Të gjitha këto elemente mbështesin aktgjykimin e kundërshtuar për dënimin e të pandehurit për veprën penale me të cilën ai ngarkohet.

Përgjegjësia e të pandehurit nuk përjashtohet edhe pse ai ka pasur mundësinë që ta ndihmonte dikë që kishte nevojë gjatë demonstratave ngase koha e fakteve duket të përputhet me veprimet e tjera të të pandehurit, i cili paraprakisht kishte marrë pjesë në manifestimet e dhunshme dhe vetëm më vonë kishte pasur mundësinë që t'u ndihmonte njerëzve që kishin nevojë për ndihmë, të cilët po vuanin nga efektet e gazit lotsjellës.

Në veçanti, dëshmia e dëshmitarit **A.R.**rreth pranisë së të pandehurit në hotelin Theranda më datën 17 mars 2004 duket të jetë e pasaktë sa i përket orës: i pyetur se në çfarë ore kishte shkuar atje G.H., ky dëshmitar ishte përgjigjur: “Diku pas orës 5:30 ose 6:00 pasdite. Nuk po më kujtohet saktësisht” (shqyrtimi i datës 18 shtator, faqe 4).

11. Sa i përket shkeljes së ligjit penal, ankesa pretendon se për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ligji material është zbatuar gabimisht pa specifikuar megjithatë më mirë këtë pikë.

Kjo gjykatë konsideron këtë pikë si të pabazë, sepse nuk është konstatuar asnjë shkelje e ligjit penal në aktgjykimin e parë, i cili ka vërtetuar përgjegjësinë e të pandehurit për veprën e pjesëmarrjes në grupin që kryen veprën penale. Koncepti i përgjegjësisë penale duke të jetë zbatuar në mënyrë të drejtë në aktgjykimin e kundërshtuar.

Në fakt, dispozita e nenit 200, par. 1 të LPK-së e dënon edhe vetë pjesëmarrjen në grupin që kryen veprën penale, pa pasur nevojë që pjesëmarrësi ta ketë kryer drejtpërdrejt veprën penale që paraqet qëllimin e këtij grupi (shih Gjykatën Supreme të Kosovës, 23 qershor 2009, Ap.-Kz Nr. 179/2007, **A.I.**et alia).

Gjykata e shkallës së parë së pari ka vërtetuar ekzistencën e manifestimeve të dhunshme më 17 dhe 18 mars 2004, që ka rezultuar në dëmtim të pronës në shkallë të madhe, në zjarrvënje dhe në lëndime trupore serioze, pastaj pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të të pandehurit në grupin që, përmes veprimit të përbashkët, kryen këto vepra.

Gjykata e shkallës së parë ka vërejtur se i pandehuri ka pasur mundësi t'i braktiste demonstratat e datës 17 mars 2004 posa ta kishte marrë vesh se demonstruesit ishin bërë të dhunshëm.

Duke mos i braktisur këto manifestime të dhunshme, H. ka treguar mbështetjen e vet ndaj tyre.

Të nesërmen, ai përsëri iu bashkua manifestimeve edhe pse e dinte se një ditë më herët kishte pasur dhunë në to. Edhe kësaj radhe, gjykata e shkallës së parë ka vepruar mirë duke bazuar dënimin e të pandehurit për faktet e ditës së dytë në fotografitë, të cilat tregojnë të pandehurin si një pjesëmarrës aktiv i manifestimit, madje edhe duke bartur flamurin dhe duke u bazuar mbi dëshminë e **B.K.**për kërcënimet që kishte marrë nga H..

Dënimi duket të jetë korrekt duke pasur parasysh si kohëzgjatjen e dënimit ligjor, nga tre muaj deri në pesë vjet burgim, të përcaktuar për veprën penale sipas nenit 200.1 të LPK-së, dhe mjetet vlerësuese të përcaktuara me nenin 64 të KPPK-së, në veçanti duke pasur parasysh seriozitetin e veprës penale, fajësinë e të pandehurit dhe sjelljen e tij të mëhershme të mirë.

Duke përfunduar, asnjë shkelje e ligjit penal nuk mund të gjendet në aktgjykimin e kundërshtuar.

12. Gjykata e shkallës së parë ka caktuar një dënim me kusht prej gjashtë muajsh burgim dhe nuk e ka llogaritur në këtë dënim kohën të cilën i pandehuri ka kaluar në paraburgim ose në arrest shtëpiak, në përputhje me nenin 391, par. 1, pikën 5 dhe nenin 278, par. 7 të KPPPK-së.

Në këtë rast, është e qartë shkelja e ligjit penal në dëm të të pandehurit por kjo mund të ndryshohet edhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme (shih precedentët konkretë të Gjykatës Supreme të Kosovës, 14 dhjetor 2004, Ap. Nr. 352/2004 dhe Pkl.Kzz. 108/2008 S.H. et alia, 12 tetor 2009).

Kështu, koha e kaluar në paraburgim prej datës 7 maj 2008 deri më 2 qershor 2008 si dhe në arrest shtëpiak nga data 2 qershor 2008 deri më 6 gusht 2008, duhet të llogaritet në kohëzgjatje të mbajtjes së dënimit për të pandehurin G.H..

III

Për këtë arsye, ankesa e të pandehurit refuzohet dhe konfirmohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, P. Nr. 339/06 i datës 28 shtator 2009, me një sqarim të vetëm se koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak duhet patjetër që të llogaritet në kohëzgjatjen e dënimit të caktuar.

Shpenzimet e procedurës së gjykatës së shkallës së dytë do të mbulohen nga ankuesi.

Sot më 19 janar 2010.
Ap.-Kz Nr. 413/2009

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Kryetari ndërkombëtar i kolegjit
Emilio Gatti

Procesmbajtësja ndërkombëtare
Judith Eva Tatrai

Gjyqtarja ndërkombëtare
Maria Giuliana Civinini

Gjyqtari i Kosovës
Avdi Dinaj

Mjeti Juridik

Kundër këtij Aktgjykimi nuk lejohet ankesë (neni 430 KCCP). Vetëm një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë është e mundur, të paraqitet në gjykatën e cila ka lëshuar vendimin e shkallës së parë, brenda 3 muajve pas dorëzimit të këtij vendimi (neni 451 – 460 KPPK).